VENDIM
Nr. 697, datë 18.11.2021

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE, ME SHKËMBIM LETRASH, TË MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT OPEC PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR (OFID), PËR PROJEKTIN E PUNIMEVE PËR RIPARIME EMERGJENTE TË AUTOSTRADËS TIRANË–ELBASAN, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 62/2018

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese, me shkëmbim letrash, të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID), për projektin e punimeve për riparime emergjente të autostradës Tiranë–Elbasan, ratifikuar me ligjin nr. 62/2018, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm

Fondi OPEC
për Zhvillim Ndërkombëtar

Znj. Anila Denaj
Ministre e Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Republika e Shqipërisë
Email: info@financa.gov.al

4 gusht 2021

Lënda: Mbi Projektin e punimeve për riparime emergjente të Rrugës Tiranë- Elbasan, Huaja e Fondit OPEC 13406, Zgjatja e Datës së Mbylljes së Huasë.

Shkëlqesia Juaj,

Dëshiroj t'i referohem letrës së Shkëlqesisë Suaj të datës 28 korrik 2021, ku kërkohet të merret në konsideratë një zgjatje e datës së mbylljes për tërheqjen e të ardhurave për huanë e përmendur.

Pas vlerësimit tonë të kërkesës së paraqitur, kam kënaqësinë të informoj Shkëlqesinë Tuaj se Fondi OPEC nuk ka asnjë kundërshtim për zgjatjen e propozuar të datës së mbylljes së huasë deri më 31 janar 2022, për të lejuar përpunimin e disbursimeve përfundimtare të huasë.

Kam besim se shtyrja do të garantojë përfundimin me sukses të aktiviteteve të projektit.

Me konsideratën time më të lartë,
Nënshkrimi

Abdulhamid Alkhalifa
Drejtor i Përgjithshëm

Fondi OPEC për Zhvillimin Ndërkombëtar . P. O Box 995. 111 Vienë. Austri
Tel: +43-1-515 64 -164; 165; . Faks +43-1-513 28 95 . Email Director-General@opecfund.org . www.opecfund.org

Fondi OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar

ANEKS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROJEKTI I PUNIMEVE PËR RIPARIME EMERGJENTE TË AUTOSTRADËS TIRANË-ELBASAN

NDRYSHIMI I DYTË I SKEDULIT 2

ALOKIMI I HUASË

1. Nëse nuk është rënë dakord ndryshe ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit OPEC, tabela më poshtë përcakton komponentët që do të financohen nga të ardhurat e Huasë, shpërndarjen e shumave të Huasë për secilin komponent dhe përqindjen e shpenzimeve totale për zërat që do të jenë financuar, në lidhje me secilin komponent:

Komponenti	Shuma e Huasë e alokuar (e shprehur në dollarë)	Përqindja e Shpenzimeve Totale që do të Financohen
(1) Punime Civile	13,249,957	26.92
(2) Shërbimet e Mbikëqyrjes dhe Konsulencës	2,559,816	42.47
(3) Menaxhim Projekti	190,227	11.43
Totali	16,000,000	

2. Pavarësisht shpërndarjes së një shume të Huasë ose përqindjeve të disbursimit të përcaktuara në tabelën në paragrafin 1 më sipër, nëse Fondi OPEC ka vlerësuar në mënyrë të arsyeshme se shuma e Huasë alokohet për ndonjë komponent, do të jetë e pamjaftueshme për të financuar përqindjen e rënë dakord të të gjitha shpenzimet në atë komponent, Fondi OPEC mund të njoftojë Huamarrësin : (i) të rialokojë në një komponent të tillë, në masën që kërkohet për të përmbushur mungesën e vlerësuar, të ardhurat e Huasë të cilat më pas u ndanë për një komponent tjetër dhe të cilat sipas opinionit të Fondit OPEC, nuk janë të nevojshme për të përballuar shpenzimet e tjera; dhe (ii) nëse një rialokim i tillë nuk mund të përmbushë plotësisht mungesën e vlerësuar, zvogëloni përqindjen e disbursimit të zbatueshme për shpenzime të tilla, në mënyrë që shpenzimet e mëtejshme në lidhje me këtë komponent të mund të vazhdojnë derisa të jenë kryer të gjitha shpenzimet e saj.

Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm

Fondi OPEC
për Zhvillim Ndërkombëtar

Znj. Anila Denaj
Ministre
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Tiranë
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

17 gusht 2021

Lënda: Ndryshimi i Dytë i Skedulit 2 të Marrëveshjes së Huasë të Fondit OPEC Nr. 13406P mbi Projektin e punimeve për riparime emergjente të autostradës Tiranë- Elbasan

Shkëlqësi,

Ky dokument i referohet letrës së Shkëlqesisë Suaj Nr. 10501, të datës 28 korrik 2021, duke kërkuar që Fondi OPEC të ndryshojë shpërndarjen e shumave dhe përqindjet e financimit në Skedulin 2, të Marrëveshjes së Huasë. Në përgjigje të saj, si dhe duke marrë parasysh arsyetimin e dhënë në lidhje me këtë, kam kënaqësinë të përcjell miratimin e Fondit OPEC për propozimin e ndryshimit.

Si rrjedhojë, Skeduli i dytë i Rishikuar, i përfshirë në Shtojcën e kësaj letre, do të zëvendësojë Skedulin 2 të Marrëveshjes së Huasë. Ky ndryshim hyn në fuqi dhe efekt që nga data e kësaj letre.

Me konsideratën time më të lartë,
Nënshkrimi

Abdulhamid Alkhalifa
Drejtor i Përgjithshëm

NS/pw
Fondi OPEC për Zhvillimin Ndërkombëtar . P. O Box 995. 111 Vienë. Austri
Tel: +43-1-515 64 -164; 165; . Faks +43-1-513 28 95 . Email Director-General@opecfund.org . www.opecfund.org